

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7049
E enjte, 16 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

Osmani kërkon
përkrahjen e Portugalisë
për anëtarësimin e
Kosovës në organizata
ndërkombëtare | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUTI "RIINVEST" KA ORGANIZUAR FORUMIN EKONOMIK VJETOR DHE KA PARAQITUR RAPORTIN "NJË MODEL I RI PËR RRRITJEN E QËNDRUESHME EKONOMIKE" | FAQE 4-5

32.72 PËR QIND E PUNËTORËVE NË KOSOVË DO TË EMIGROJNË GJATË VITIT TË ARDHSHËM



Bizneset kanë raportuar se 17.59 për qind e punonjësve të tyre veçse i kanë informuar se do të emigrojnë vitin e ardhshëm. Ndërkaq vlerësimet e bizneseve

janë se rreth 32.72 për qind e punëtorëve do të emigrojnë gjatë vitit të ardhshëm, kur pritet të liberalizohen vizat për Zonën Schengen. Kështu është thënë në

Forumit Ekonomik vjetor të organizuar nga Instituti "Riinvest", me rastin e paraqitjes të raportit "Një model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike"

QEVERIA KURTI
NDAU 113 MILIONË
EURO PËR DY VJET
PËR FURNIZIM ME
RRYMË NË VERI



PROBLEMET
KRYESORE NË
BALLKANIN
PERËNDIMOR:
KORRUPSIONI,
KRIMI I
ORGANIZUAR
DHE EMIGRIMI



AKTUALE



GRATË NË BE, SIPAS KE-së, ENDE
PAGUHEN 13 % MË PAK SE BURRAT

F. 2

PDK-ja: STATUTI I ASOCIACIONIT
DUHET TË JETË NË PAJTIM ME
KUSHTETUTËN DHE LIGJET E
KOSOVËS F. 8

LDK-ja: KA QASJE TENDENCIOZE TË
QEVERISË PËR T'UA VËSHITËSUAR
PUNËN KOMUNAVE F. 6

EKONOMI



ARRIHET MARRËVESHJE
ME USAID-IN PËR KRIJIMIN
E SISTEMIT ELEKTRONIK PËR
PËRCJELLJEN E FATURAVE F. 8

SHËNOHET JAVA BOTËRORE E
NDËRMARRËSISË NË PARKUN E
INOVACIONIT DHE TRAJNIMIT NË
PRIZREN F. 8

SPORT



"DARDANËT" NËPËR SHI
VAZHDOJNË PËRGATITJET PËR
NDESHJEN NDAJ ZVICRËS F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Negociatorët e BE-së arrijnë marrëveshje për zvogëlim të emetimeve të metanit

BRUKSEL, 15 NËNTOR - Negociatorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian kanë arritur të mërkurën një marrëveshje për rregullat e reja për zvogëlim të emetimeve të metanit, të cilat më pas do të rezultojnë me kërkesa të tjera për industrinë e thëngjillit, gazit dhe naftës. "Teksti përfaqëson kontribut kyç për veprim klimatik, pasi metani është gaz i fuqishëm serrë, i dyti pas dyoksidit të karbonit, dhe në përgjithësi ndikon në ndryshime klimatike dhe është përgjegjës për një të tretën e ngrohjes aktuale të klimës", ka thënë Teresa Ribera, ministre spanjolle për Ekologji. Kjo marrëveshje, e cila duhet të miratohet zyrtarisht për t'u

shndërruar në ligj, është arritur vetëm dy javë para nisjes së Samitit të Kombeve të Bashkuara për Klimën që do të mbahet në Dubai.

Marrëveshja kërkon masa të reja për t'i monitoruar emetimet e metanit, sidomos ato të sektorit që prodhon energji me naftë të papërpunuar.

Dokumenti, po ashtu, bën thirrje që masat për këtë industri të paraqiten në tri faza.

Komisioni Evropian e ka komentuar marrëveshjen e së mërkurës si "kyçe" për luftën e BE-së ndaj ndryshimeve klimatike. Ai ka thënë se për më shumë se një shekull, metani, në krahasim me dyoksidin e karbonit, ka qenë 28 herë më i fuqishëm në ngrohjen globale.



Gratë në BE, sipas KE-së, ende paguhen 13 % më pak se burrat

Bruksel, 15 nëntor - Gratë në Bashkimin Evropian (BE) paguhen mesatarisht 13 për qind më pak se burrat të cilët e bëjnë të njëjtën punë, tha Komisioni Evropian (KE) të martën. Kjo po ndodh për shkak se BE-ja e ka një ligj tashmë për pagë të barabartë. "Pagë e barabartë për punën e njëjtë, apo për punë të vlerës së njëjtë, është një nga parimet thelbësore të BE-së. U vendos në Traktatin e Romës më 1957",



tha Komisioni në një komunikatë.

KE-ja shtoi se, megjithatë, përparimi në eliminimin e hendekut gjinor në paga ka ngecur dhe ka qenë i ngadaltë në vitet e fundit.

Për të ndihmuar në adresimin e këtij problemi, Komisioni Evropian e ka themeluar një Direktivë për Transparencë në Pagesë, e cila hyri në fuqi në fillim të qershorit.

Direktiva, një ligj i BE-së,

vendos për kornizën se si të aplikohet ideja e "punës së vlerës së njëjtë" dhe kriteret krahasore të cilat përfshijnë aftësitë, përpjekjet, përgjegjësitë dhe kushtet e punës.

Direktiva ka për qëllim t'i ndihmojë punëtorët ta vërejnë diskriminimin në pagë dhe ta sfidojnë atë, por kjo direktivë ende nuk është bërë ligj në 27 vendet e BE-së të cilat i kanë tri vjet kohë për ta bërë këtë.

Dhoma e Përfaqësuesve miraton projektligjin që shmang mbylljen e Qeverisë amerikane

UASHINGTON, 15 NËNTOR - Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ka miratuar një projektligj të përkohshëm për shpenzime që do ta shmangë mbylljen e qeverisë amerikane. Projektligji është miratuar nga të dyja partitë.

Projektligji, i cili do ta mundësojë rrjedhjen e fondeve qeveritare deri në mesin e muajit janar, tani shkon për miratim në Senat, ku liderët demokratë dhe ata republikanë kanë ofruar mbështetjen e tyre.

Për ta parandaluar mbylljen, Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga republikanët, duhet ta miratojnë legjislacionin, që duhet nënshkruar nga presidenti amerikan Joe Biden në ligj, para se vendimi për fondet aktuale për agjencitë federale të skadojë në mesnatën e së premtes.

Vota e së martës ka qenë fitore për

udhëheqësin e Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, i cili është përballur me kundërshtime nga disa republikanë, në tentimin e parë për këtë votim.

Johnsoni është zgjedhur në pozitën e udhëheqësit më pak se tri javë më parë, pasi disa javëve të kaosit në Dhomën e Përfaqësuesve, në tentim e sipër për të pasur lider.

Lideri i shumicës në Senat, demokrati Chuch Schumer, ka thënë përmes një deklaratë se është gëzuar që projektligji ka ecur përpara "me mbështetje të fortë dypartiake", duke shtuar se ai do të punojë me republikanin në Senat, Mitch McConnell, për ta miratuar atë "sa më shpejt që është e mundur".

Projektligji aktual do t'u japë më shumë kohë ligjvënësve që t'i analizojnë hollësitë për financat e vitit të ri buxhetor, të cilat përfshijnë gjithçka prej ushtrisë e



deri te hulumtimet shkencore.

Paraardhësi i Jonhsonit si udhëheqës i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, është shkarkuar nga kjo pozitë prej republikanëve, pasi në një votim të ngjashëm në shtator ai është varur nga votat e demokratëve për ta shmangur mbylljen qeveritare.

Mirëpo tani disa republikanë kanë thënë se projektligji që është miratuar, është më i mirë sesa opsionet e tjera. "Nuk është ideal", ka thënë republikani Mike Garcia. "Mirëpo mbyllja është shumë më e keqe".

Në projektligjin e miratuar parashihen fonde për ushtrinë,

përfitime për veteranët, transport, banim, zhvillim urban, bujqësi, për programet e energjisë dhe ujit, edhe për Administratën Amerikane për Ushqim dhe Ilaçe deri më 19 janar.

Fondet për operacionet e tjera qeveritare parashihen të skadojnë më 2 shkurt.

Osmani kërkon përkrahjen e Portugalisë për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare

LISBONË, 15 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë vizitës në Portugalë është prituri në takim nga presidenti Marcelo Rebelo de Sousa në Pallatin Presidencial "Belem" në Lisbonë. Sipas presidentes Osmani, vizita e dytë në këtë shtet është dëshmi e marrëdhënieve të shkëlqyera dypalëshe të cilat tashmë ndodhen në një fazë dinamike me fokus në shtimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat.

Vizita e presidentes Osmani përkon me 15-vjetorin e njohjes së Kosovës nga Portugalia dhe lidhjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve. "Ky është një moment i rëndësishëm dhe historik për ta shprehur mirënjohjen për shtetin dhe popullin e Portugalisë për kontributin e dhënë përgjatë viteve. Kjo mbështetje ka ndikuar shumë në avancimin e qëllimeve tona parësore në rrugën e integritimit euroatlantike,



forcimin e paqes dhe stabilitetit rajonal", ka theksuar Osmani. Më tej, ajo ka thënë se e sheh Portugalinë si një shtet mik brenda Bashkimit Evropian dhe më gjerë, ndaj ka shtuar se

shpreson në mbështetje të mëtejme për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Në këtë kontekst, presidentja ka falënderuar Portugalinë për mbështetje në

procesin e liberalizimit të vizave dhe për anëtarësimin në Këshillin e Evropës, si dhe ka shfaqur shpresën se Portugalia do ta përkrahë edhe dhënien e statusit kandidat në BE për republikën

tonë.

Një pjesë e takimit iu kushtua zhvillimeve të fundit politike dhe të sigurisë në Kosovë.

Presidentja Osmani e informoi homologun De Sousa edhe për zhvillimet e fundit në vend si dhe mbi aktin e agresionit të Serbisë kundër Republikës së Kosovës më 24 shtator, me ç'rast potencoi rëndësinë e sjelljes para drejtësisë në Kosovë të grupit paramilitar serb dhe adresimin e përgjegjësisë së Serbisë në destabilizimin e Kosovës dhe rajonit.

Presidentja, po ashtu, potencoi se në procesin e dialogut me Serbinë, Kosova është palë konstruktive dhe se përmbyllja e këtij procesi përmes njohjes së ndërsjellë është e vetmja rrugë që do të sjellë paqë afatgjatë në rajon.

Në këtë takim, presidentja Osmani dhe presidenti De Sousa kanë diskutuar edhe për mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në sfera të interesit të dyanshëm.

Marrëveshja Shqipëri - Itali për emigrantët "nuk shkel ligjin e BE-së"

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Marrëveshja që i mundëson Italisë të ndërtojë qendra të pranimit në Shqipëri për mijëra emigrantë të shpëtuar në Mesdhe nuk shkel ligjin e Bashkimit Evropian, i cili nuk zbatohet për këtë çështje, tha zyrtarja kryesore e bllokut për migrimin.

Marrëveshja, e arritur javën e kaluar, u kritikua nga organizatat për të drejtat e njeriut dhe u krahasua me planin e qeverisë britanike për dërgimin e azilkërkuesve në Ruandë, plan që u vlerësua i jashtëligjshëm nga Gjykata Supreme britanike. "Vlerësimi fillestar i shërbimit tonë ligjor është se [marrëveshja Shqipëri - Itali] nuk shkel ligjin e BE-së, është jashtë ligjit të BE-së", tha

komisionarja për migrim e BE-së, Ylva Johansson, kur u pyet në një konferencë për medie në Bruksel lidhur me marrëveshjen në mes të Shqipërisë dhe Italisë. Deklaratat e saj sugjerojnë se kjo marrëveshje nuk do të dërgohet për shqyrtim para Gjykatës së Drejtësisë të BE-së.

Më 6 nëntor kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe homologia e tij italiane, Giorgia Meloni, nënshkruan marrëveshje, sipas së cilës, Italia do të dërgojë në Shqipëri emigrantët që shpëton në Detin Mesdhe, ndërsa Italia do ta financojë ngritjen e qendrave për pritjen e tyre.

Marrëveshja do të nisë së zbatuari në pranverën e vitit të ardhshëm.

Sipas protokollit të publikuar

nga qeveria shqiptare, Italia do të depozitojë 16.5 milionë euro në një llogari të posaçme të Thesarit të Shqipërisë si paradhënie për strehimin e emigrantëve.

Komisionarja e lartë për të drejtat e njeriut në Këshillin e Evropës, Dunja Mijatović, ka deklaruar se marrëveshja e arritur në mes të Shqipërisë dhe Italisë për emigrantët rrit shqetësimet për të drejtat e njeriut dhe shton shqetësimet për trendin evropian që përgjegjësitë për azilkërkuesit të dalin jashtë kornizës evropiane. Po ashtu, marrëveshja është kritikuar nga Organizata për të Drejtat e Njeriut "Amnesty International", që e ka quajtur atë "të jashtëligjshme dhe të pazbatueshme".



Kurti takon ambasadorin e ri të Shqipërisë: Të forcohen marrëdhëniet vëllazërore për anëtarësim në NATO dhe BE



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti ka prituri të mërkurën në takim ambasadorin e ri të Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj. Kurti e ka përgëzuar ambasadorin për detyrën e re. Ai i ka vlerësuar marrëdhëniet vëllazërore mes dy shteteve tona, duke theksuar rëndësinë e thellimit dhe avancimit të bashkëpunimit. Biseduan për rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku bashkëpunimi midis shteteve duhet të jetë i bazuar në demokraci e siguri,

në orientimin dhe vlerat e NATO-s dhe të BE-së.

Kurti veçoi marrëveshjet në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, zbatimin e cilave forcon marrëdhëniet tona dhe i sjellë qytetarët më pranë njëri-tjetrit. Ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë e pozitiv në jetën e tyre, të bizneseve e më gjerë. Marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë kanë sjellë nënshkrimin e

gjithsejtë 184 marrëveshjeve, protokolleve e memorandumeve.

Ndërkaq ambasadori Malaj shprehu përkushtimin e tij për t'i çuar më tej marrëdhëniet tona të shkëlqyera. Ai theksoi se ndihet i nderuar dhe i lumtur që do të shërbejë në Kosovë. Duke i uruar suksese në këtë angazhim të ri, kryeministri Kurti e falënderoi ambasadorin Malaj për takimin dhe bisedën e frytshme.



INSTITUTI "RIINVEST" KA ORGANIZUAR FORUMIN EKONOMIK VJETOR DHE KA PARAQITUR RAPORTIN "NJË MODEL I RI PËR RITJEN E QËNDRUESHME EKONOMIKE"

32.72 për qind e punëtorëve në Kosovë do të emigrojnë gjatë vitit të ardhshëm

Bizneset kanë raportuar se 17.59 për qind e punonjësve të tyre veçse i kanë informuar se do të emigrojnë vitin e ardhshëm. Ndërkaq vlerësimet e bizneseve janë se rreth 32.72 për qind e punëtorëve do të emigrojnë gjatë vitit të ardhshëm, kur pritet të liberalizohen vizat për Zonën Schengen. Kështu është thënë në Forumin Ekonomik vjetor të organizuar nga Instituti "Riinvest", me rastin e paraqitjes të raportit "Një model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike"

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Instituti "Riinvest" ka organizuar të mërkurën Forumin Ekonomik Vjetor, me ç'rast ka paraqitur edhe raportin "Një model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike". Raporti është i ndarë në tri pjesë. Në pjesën e parë trajtohet ecuria e rritjes ekonomike përgjatë disa viteve të fundit në kontekstin e

konfiguracionit makroekonomik të Kosovës të karakterizuar me shpërpjesëtime të shprehura, veçanërisht me papunësinë e lartë dhe deficitin tepër të lartë tregtar të Kosovës.

Në pjesën e dytë adresohet mjedisi biznesor në Kosovë dhe refleksionet e tij në situatën ekonomike sivjet dhe vitin e ardhshëm. Në pjesën e tretë është tema qendrore e këtij raporti, që ka të bëjë me lëvizjet më të reja në tregun e punës të ndikuara nga

trendi permanent i migrimit të popullatës dhe fuqisë punëtore të punësuar kryesisht në BE, problemin e pagave në sektorin privat dhe atë publik. Pas daljes nga faza e incidencës së lartë të Covid-19 dhe rritjes ekonomike prej 10.7-përqindësh në vitin 2021, në vitet vijuese ekonomia e Kosovës kthehet afërsisht te një rritje karakteristike në dekadën e fundit 3-4 për qind, përkatësisht 3.5 për qind në vitin 2022.

Një tendencë ngadalësimi përshkon vitin 2023 në tremujorin e parë (2.9 për qind) dhe në tremujorin e dytë (2.06 për qind), shoqëruar kjo edhe me përkeqësimet në rritjen e eksportit dhe në bilancin tregtar. Sipas të gjitha gjasave, gjykuar edhe sipas parashikimeve dhe për rrjedhat ekonomike në Bashkimin Evropian (BE), dhe në planin global kjo do të mbetet një karakteristike e ecurive edhe për vitin 2024. Ky nivel i rritjes është nën pritjet dhe përcaktimet e Qeverisë së Kosovës në

Programin Qeveritar dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) e cila kishte parashikuar një rritje mbi 5 për qind për të tri vitet brenda periudhës 2022-2024. Në dokumentet që shoqërojnë projektbuxhetin e vitit 2024, parashikohet një rritje prej 4.6-përqindësh, theksohet në prezantimin e këtij raporti. Më tutje thuhet se Kosova është e mbërthyer brenda një kornize politikash e faktorësh që, siç provojnë statistikën për më shumë se një dekadë e gjysmë, e mbajnë të pandryshueshme strukturën e Produktit Vendor Bruto (PVB). Sektorët prodhues dhe industria përpunuese nuk kanë arritur ndonjë përmirësim. Si pasojë, modeli ekzistues i rritjes ekonomike, i bazuar në faktorët e jashtëm, pothuajse ka harxhuar fuqinë e tij për rritje ekonomike transformuese. Atij po i mungojnë shtytësit zhvillimorë dhe më tepër po konservon një gjendje që në teorinë dhe praktikën e zhvillimit njihet si

kurthi zhvillimor i vendeve me të ardhura mesatare.

Tejkalimi i këtij problemi, edhe në rastin e Kosovës, duhet të bëhet me promovimin e modelit të ri të rritjes ekonomike të bazuar në politikat e rritjes së ofertës konkurruese të produkteve dhe shërbimeve për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Kjo nënkupton edhe një përdorim më efektiv të fondeve publike, sidomos në dobi të një investimi më frutdhënës në arsim, shëndetësi dhe kërkime e inovacion. Me këtë krijohen kushtet afatgjata për ta ngritur potencialin për rritje ekonomike të qëndrueshme, sidomos duke u ndërlidhur me angazhimet e tanishme, shumë të rëndësishme, lidhur me hartimin dhe aprovimin e Strategjisë së Specializimit të Mençur (S3), Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, zbatimin e Agjendës së Gjelbër dhe Digitalizimit. Në kuadër të kësaj duhen rritur ndjeshëm investimet publike dhe private në

Kosova në seminarin e AP të NATO-s: Bazat e ushtrisë serbe ende janë në afërsi të vijës kufitare me Kosovën

Sarajevë, 15 nëntor - Në Sarajevë ka filluar punimet Seminari i 105 "Rose-Roth" i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në bashkëpunim me Komitetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë të AP të NATO-s, në të cilat po merr pjesë edhe delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, i kryesuar nga Driton Hyseni dhe i shoqëruar nga Xhavit Haliti, anëtar.

Për tri ditë sa do të zgjasë seminari 105 "Rose-Roth" i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, do të analizohet situata politike dhe e sigurisë në rajon, shtensionimi i marrëdhënieve dhe ulja e tensionit nationalist në mes të vendeve e

kombeve të shteteve të Ballkanit, me fokus në Bosnjë-Hercegovinë. Në ditën e parë është diskutuar për sigurinë në rajon, veçanërisht ngjarjet e fundit të cilat paraqesin rrezik për sigurinë në rajon siç ishte sulmi i 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit.

Kryesuesi i delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Driton Hyseni, ka thënë se është e rëndësishme të tregojnë se, pavarësisht shkurtimit të një pjese të ushtrisë serbe në kufi me Kosovën, e cila kishte shtuar numrin e pjesëtarëve të saj pas sulmit terrorist në shtator, bazat e ushtrisë serbe ende janë në afërsi të

vijës kufitare me Kosovën.

Hyseni, gjithashtu, vuri në dukje se nga këto baza ushtarake dhe nga ndikimi i zyrtarëve shtetërorë serbë buron influencimi për tensione përmes strukturave kriminale në veri të Kosovës.

Më tutje, Hyseni veçoi se situata aktuale është e qetë dhe se me zbehjen e ndikimit të strukturave të Serbisë në veri të vendit, qytetarët kanë filluar të jetojnë më mirë në këtë pjesë dhe normalizimi i plotë është në rrugën e duhur. "Qytetarët në veri të vendit po pajisen me dokumentet e Republikës së Kosovës. Edhe procesi i regjistrimit të veturave dhe pajisja me tabela të

Republikës së Kosovës është në nivel të kënaqshëm", ka thënë Hyseni.

Udhëheqësi i delegacionit të Kuvendit të Kosovës, Driton Hyseni, ka trajtuar si temë edhe sfidën e vendeve të Ballkanit, si dhe të vendeve të NATO-s për zbehjen e interesimit të të rinjve për t'u rekrutuar në forcat ushtarake.

Ndërsa në adresimin drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme të Bosnjë-Hercegovinës, Elmedin Konaković, Hyseni e uroi atë për ratifikimin e dy marrëveshjeve të arritura përmes Procesit të Berlinit, por kërkoi informacion se kur Bosnja dhe Hercegovina do ta

ratifikojë në parlament edhe marrëveshjen për lëvizjen e qytetarëve mes shteteve vetëm me letërnjoftim, duke insistuar që kjo të realizohet sa më parë.

Në seminar po marrin pjesë përfaqësuesit e delegacioneve të vendeve të ndryshme, anëtare në Asamblenë Parlamentare të NATO-s.

Çështjet e tjera të cilat u diskutuan përfshijnë zhvillimet e fundit në Bosnjë-Hercegovinë, promovimin e demokracisë dhe rritjen ekonomike në Bosnjë-Hercegovinë si dhe perspektivën euroatlantike të Bosnjë-Hercegovinës.

Seminari do t'i vazhdojë punimet edhe të enjten.



kërkime dhe inovacion. Së paku këto investime të arrijnë mesataren rajonale (prej rreth 0.5 për qind të PVB-së) për një periudhë 2-3-vjeçare. "Për më tepër, bizneset raportojnë se 17.59 për qind e punonjësve të tyre veçse i kanë informuar se do të emigrojnë vitin e ardhshëm. Vlerësimet e bizneseve janë se rreth 32.72 për qind e punëtorëve do të emigrojnë gjatë vitit të ardhshëm, kur pritet të liberalizohen vizat për në Zonën Shengen. Për të frenuar këtë trend, vetëm gjatë vitit të fundit 79 për qind e bizneseve kanë rritur pagat e tyre dhe rritja e pagave ishte 22.23 për qind. Mbi një e treta e bizneseve raportojnë se do të vijojnë t'i rritin pagat, përderisa 24,5 për qind planifikojnë t'i përmirësojnë kushtet e punës, ndërsa 20,6 për qind planifikojnë të punësojnë gra (kryesisht në moshë të mesme), dhe 10,4 për

qind planifikojnë të investojnë në teknologjitë e reja që synojnë automatizimin e proceseve të punës", thuhet në raportin "Një model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike".

Nga ana e ofertës, evidentohet një prirje e lartë për emigrim. Pothuajse gjysma e të rinjve të anketuar kanë pohuar se ata synojnë të emigrojnë në dy vitet e ardhshme. Për më tepër, një e treta e atyre që kanë lënë punën, e ka bërë një gjë të tillë për shkak të emigrimit. "Hartuesit e politikave duhet të përqendrohen në minimizimin e faktorëve shtytës në mënyrë që të ulet prirja për të emigruar. Është me rëndësi të ceket se papunësia duket se është vetëm një nga faktorët domethënës shtytës. Arsyja kryesore për emigracionin mbetet mundësia për 'jetë më cilësore për veten ose familjen' (27 për qind), e ndjekur nga 'gjetja

e një pune ose një punë më të mirë' (26 për qind), 'ndjekja e studimeve të mëtutjeshme' (14 për qind) ose 'faktorët e kombinuar' (32 për qind). Analizimi i prirjes për të migruar dhe reagimi i vendosur në lidhje me migracionin ka implikime të rëndësishme politike dhe menaxheriale. Lidhur me këtë, janë analizuar edhe dy modele: (i) përcaktuesit që nxisin emigrimin nga Kosova, me theks të veçantë në demografinë e të rinjve, dhe (ii) karakteristikat e bizneseve që kanë humbur punëtorët për shkak të migrimit. Rezultatet e këtyre modeleve dhe ato nga analiza përshkruese ofrojnë rekomandime të rëndësishme të politikave", theksohet në raport. Bazuar në gjetjet dhe konstatimet e këtij raporti është rekomanduar që: 1. Brenda një afati racional të bëhet rishikimi i politikave ekzistuese ekonomike dhe

efektivitetit të zbatimit të tyre në harmoni me nevojën për promovimin dhe zbatimin e modelit të ri të rritjes ekonomike të përqendruar në rritjen e qëndrueshme të ofertës së produkteve shërbimeve; 2. Të dizajnohet dhe zbatohet një model politikash efektive të ngritjes së aftësisë konkurruese, sidomos duke mbështetur sektorët eksportues; 3. Në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat të lansohen programe të mbështetjes (vija kreditore) të investimeve afatgjate të sektorëve industrial dhe shërbimeve; 4. Investimet jashtme direkte sidomos ato nga diaspora të kanalizohen me stimuj të caktuar në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve me vlerë të lartë shtuese; 5. Të rishikohen politikat buxhetore në favor të krijimit të një përpjesëtimi më të mirë

struktural, para së gjithash në favor të investimeve kapitale dhe për të arritur një pozitë më të volitshme të financimit të arsimit, shëndetësisë, kërkimeve dhe inovacioneve së paku në nivel rajonal dhe përafëruar me standardet evropiane; 6. Për të parandaluar nivelin e lartë të emigrimit kërkohet një strategji gjithëpërfshirëse e cila kërkon përmirësime, ndër të tjera, të sistemit të përgjithshëm arsimor, sistemit shëndetësor dhe kushteve të punës në përgjithësi si dhe në sistemin e pagave në sektorin publik dhe privat. 7. Nevojitet një aktivitet i përqendruar dhe sistematik për evitimin e barrierave administrative dhe të zbatimit të ligjit nga të gjitha institucionet dhe agjencitë përgjegjëse dhe për të zbatuar Programin e Qeverisë për Parandalimin e Barrës Administrative (2020-2027).

Fillon projekti i transformimit të Kodrës së Sherretëve në Ferizaj

FERIZAJ, 15 NËNTOR - Komuna e Ferizajt, në vazhden e zbatimit të agjendës së gjelbër, ka nisur projektin e transformimit të Kodrës së Sherretëve.

Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu,

ka thënë se kjo hapësirë do të shndërrohet në një nga parqet më të bukura të Ferizajt. “Qeverisja jonë, që fokus ka të gjelbrën, po jetësohet përmes projekteve për rregullimin e masiveve të gjelbra si Kodra e

Sherretëve, e cila do të shndërrohet në një nga parqet më të bukura të Ferizajt e ku tashmë kemi nisur punimet fillestare të rregullimit të hapësirave në këtë zonë”, ka shkruar Aliu në “Facebook”.



Situata e sigurisë në Rahovec, e qetë

RAHOVEC, 15 NËNTOR - Situata e përgjithshme në komunën e Rahovecit është e qetë. Kështu është thënë të mërkurën në takim të gjashtë për këtë vit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në të cilin ka marrë pjesë edhe kryetari Smajl Latifi. Në këtë takim është diskutuar për digjitalizimin e ndriçimit publik, sigurinë në trafik, lirim të trotuareve, shënjimin e rrugëve, për raportimin e shkeljeve ligjore,



për masat parandaluese për dhunën në familje dhe sigurinë në shkollë.

Komandanti i Stacionit të Policisë në Rahovec, Fazli Morina, ka folur rreth situatës së sigurisë në këtë komunë, duke theksuar se kanë ndodhur 81 vepra penale, 5 incidente jopenale, 8 lëndime të lehta, 4 raste të dhunës në familje, 2 raste të armëmbajtjes pa leje dhe janë arrestuar 20 persona.

Sa i përket sigurisë në komunikacionin rrugor, ai ka thënë se janë shqiptuar 1 398 gjoba, 52 raste pa patentë, 204 për parking joadekuat, 22 gjoba për përdorim të telefonit gjatë ngasjes, 20 aksidente me dëme materiale dhe 18 aksidente me lëndime trupore. Ndërkaq rreth sigurisë në shkollë, ai ka bërë me dije se janë raportuar dy raste të incidentit në shkollë që kanë rezultuar me dëme materiale.

LDK-ja: Ka qasje tendencioze të qeverisë për t'ua vështirësuar punën komunave

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka mbajtur të mërkurën tryezë diskutimi me përfaqësues të sindikatave dhe të organizatave joqeveritare në lidhje me projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2024.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se ka pasur qasje tendencioze të qeverisë për ta vështirësuar punën e komunave. “Ajo çfarë vërejmë

tash është kujdesi i qeverisë në fushën e ekonomisë lokale. Vazhdon të jetë bindja se mungojnë projektet zhvillimore dhe ideja se si të qeveriset. Jemi në vitin e fundit të qeverisjes së kësaj qeverie dhe nuk kemi asnjë projekt të madh zhvillimor. Kryesisht është marrë me skema sociale, ku ndikimi është i vogël”, tha ai. Sipas Gashit, tash e gati gjashtë muaj nuk është miratuar asnjë marrëveshje ndërkombëtare dhe se ekonomia e Kosovës “vuan për para”.



Së shpejti fillon projekti për rregullimin e infrastrukturës në sheshin “Shatërvan”



PRIZREN, 15 NËNTOR - Së shpejti fillon realizimi i projektit për rregullimin e komplet infrastrukturës në sheshin “Shatërvan”. Kryetari Shaqir Totaj, në takim të mërkurën me përfaqësuesit e KEDS-it, të udhëhequr nga zyrtari i pajtueshmërisë në

KEDS, Avni Alidemaj, ka diskutuar për shtrimin e rrjetit të kabllove nëntokësore të rrymës, përfshirë edhe ato të operatorëve të furnizimit me internet e shërbime të tjera teknologjike.

Në takim është theksuar se punimet do të realizohen me

dinamikë të përshpejtuar duke pasur parasysh numrin e madh të bizneseve që operojnë në qendër të Prizrenit. Gjithashtu, është thënë se projekti do të përmbyllet me rregullimin e kalldrimit, i cili do ta rikthejë pamjen e merituar të kësaj zone të qytetit të Prizrenit.

Vazhdon rregullimi i varrezave të dëshmorëve në Marec

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se është duke vazhduar realizimin e projektit për rregullimin e varrezave të dëshmorëve në Marec. Ai të mërkurën ka vizituar këtë

vend për t'i parë punimet. “Jemi duke punuar në projektin i cili do të sjellë një ndryshim të dukshëm në varrezat e dëshmorëve tanë. Do të bëhet përmirësimi i infrastrukturës së varrezave dhe do të kemi një dizajnim

të një ambienti respektues dhe të përshtatshëm. Në përgjithësi do të ketë përmirësim të kushteve për familjarët dhe miqtë që i vizitojnë varrezat e dëshmorëve në Marec”, ka thënë kryetari Rama.



Problemet kryesore në Ballkanin Perëndimor: korrupsioni, krimi i organizuar dhe emigrimi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHINË, 15 NËNTOR - "Emigrimi po bëhet një nga problemet më të mëdha në ditët e sotme, sepse vendet po zbrazen. Jo vetëm ato që rezultojnë në fluksin e emigrantëve në rajonin tonë, por edhe për shkak të emigrimit nga rajoni ynë më në perëndim. Prandaj, sfidat e sigurisë po ndryshojnë në mënyrë dramatike. Sfidë e sigurisë nuk është vetëm zgjidhja apo parandalimi i konflikteve, por edhe ndryshimet klimatike dhe katastrofat, spiunazhi dhe problemet reale të jetëve njerëzore. Si ikja e trurit që po bëhet jo vetëm çështje e kapitalit njerëzor, por edhe një çështje sigurie", ka thënë sekretarja e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Majlinda Bregu, në hapjen e Konferencës së Tetë të Koordinimit Rajonal të Sigurisë në Romë.

Edicioni i tretë i sondazhit të opinionit publik të RCC-së "Securi Meter" është paraqitur në konferencë, duke zbuluar se çfarë mendojnë qytetarët e rajonit për çështjet e sigurisë. "Shqetësimet

kryesore të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor janë korrupsioni dhe krimi i organizuar. Më shumë se 60 % e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor e renditin krimin e organizuar si shqetësimin kryesor të sigurisë, i cili shkon paralelisht me korrupsionin me 55 % të qytetarëve të rajonit që besojnë se niveli i korrupsionit është rritur. Kur flasim për migracionin, 70 % e qytetarëve tanë pajtohen se rajoni ynë duhet t'i strehojë emigrantët që kanë nevojë për mbrojtje, por shumica, 80 %, beson se BE-ja duhet të bëjë më shumë për ta ndarë barrën. Bashkëpunimi rajonal edhe në këtë fushë mbështetet në masë të madhe, pasi 73 % është i mendimit se thellimi i bashkëpunimit rajonal për t'i kontrolluar kufijtë në mes të Ballkanit Perëndimor si një rajon është një mënyrë për ta menaxhuar migracionin e parregullt", ka theksuar Bregu.

"Securi Meter" u krye midis 14 majit dhe 2 qershorit 2023 me 6 023 njerëzve të rajonit. Të dhënat tregojnë se shumica e emigrantëve potencialë nga rajoni ynë, 62 % e tyre planifikojnë qëndrime afatgjatë jashtë vendit për vite ose përgjithmonë. Pothuajse gjysma e qytetarëve



tanë, 47 %, besojnë se dezinformimi shkakton më shumë dëm në provokimin e urrejtjes dhe mendimeve përçarëse. Ata mendojnë se mediet sociale janë ato që kanë më shumë gjasë të përhapin lajmet e rreme - 46 %, ndjekur nga afër nga gazetarët me 44 % dhe politikanët me 38 %.

"Securi Meter" tregon shumë tendenca shqetësuese, nga

migrimi të frika e luftës, siguria kibernetike dhe dezinformimi. Të gjitha këto sfida do të kenë nevojë për të investuar përpjekje të forta për t'iu përgjigjur atyre. Ne të gjithë jetojmë shumë afër njëri-tjetrit për të mos trajtuar sfidat e sigurisë si një çështje dhe adresim të përbashkët, duke forcuar gjithmonë bashkëpunimin tonë", ka përfunduar Bregu.

Konferenca dyditore do të

fokuset në sfidat dhe kërcënimet e sigurisë rajonale në Ballkanin Perëndimor, duke shfaqur shtatë panele të lidhura me sigurinë, dhe sesione ndërvepruese, grupe pune dhe mundësi rrjetëzimi. Ajo synon të nxisë diskutime të thella, ta promovojë bashkëpunimin midis palëve të interesuara dhe të kontribuojë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e Ballkanit Perëndimor.

PDK-ja: Statuti i Asociacionit duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës

PRISHINË, 15 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka zhvilluar takime të ndara me kryesinë e partisë, me deputetët e grupit parlamentar të PDK-së dhe me kryetarët e degëve, në të cilat kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend. Krasniqi ka shprehur shqetësimin e tij për mungesën e transparencës nga kryeministri Albin Kurti në raport me procesin e dialogut, përkatësisht me draft-statutin e Asociacionit, për të cilin nuk ka dhënë ende asnjë hollësi për deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe për qytetarët.

Ai ka thënë se deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të njoftohen zyrtarisht nga kryeministri i Kosovës për përmbajtjen e dokumentit që ka pranuar, si dhe duhet ta dinë se deri në çfarë mase drafti i statutit të Asociacionit do ta ndryshojë rregullimin e brendshëm dhe karakterin unitar



të shtetit tonë.

Krasniqi ka ripërsëritur qëndrimin se për PDK-në është i

papranueshëm çfarëdoj statuti, i cili e parasheh formimin e Asociacionit me kompetenca që

bien ndesh me idealet themeluese të Republikës së Kosovës.

Gjatë këtyre takimeve u tha se

regresi ekonomik, sanksionet ndërkombëtare dhe përkeqësimi i mirëqenies së qytetarëve janë vetëm disa nga pasojat, krahas dështimit në dialog, të cilat vijnë si rezultat i keqeverisjes, arrogancës dhe aferave të vazhdueshme korruptive të zyrtarëve qeveritarë. Krasniqi i ka njoftuar zyrtarët e PDK-së edhe për takimin me të dërguarin e posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, javën e kaluar, të cilët i ka njoftuar se i ka kërkuar atij që Bashkimi Evropian t'i heqë sa më parë sanksionet e padrejta ndaj Republikës së Kosovës.

Kreu i PDK-së ka thënë se në takimet e këtyre ditëve ka shprehur qëndrimin konsistent se statuti i Asociacionit duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, të mos krijojë një nivel të ri të pushtetit dhe të mos ketë kompetenca ekzekutive.

Specialja ua vazhdon paraburgimin Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit

Hagë, 15 nëntor - Gjykata Speciale ka marrë vendim për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Trupi gjykues në rastin ndaj ish-krerëve të UÇK-së që po gjykohen në Dhomat e Specializuara në

Hagë ka vendosur që edhe ish-kryeparlamentarët Jakup Krasniqi t'i vazhdohet paraburgimi edhe për dy muaj.

Paraburgimi i është vazhduar edhe Rexhep Selimit.

Më 3 prill në Hagë ka nisur gjykimi ndaj ish-krerëve të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-deputeti Rexhep Selimi janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.



Qeveria Kurti ndau 113 milionë euro për dy vjet për furnizim me rrymë në veri

Prishtinë, 15 nëntor - 63.2 milionë euro i ka kushtuar vendit furnizimi me energji elektrike të katër komunave veriore për vitin 2022, ka bërë me dije kryesuesi i Bordit të KOSTT-it, Jeton Mehmeti, në Komisionin Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere. Ai ka thënë se energjia elektrike e harxhuar nga serbët në veri të vendit është mbuluar përmes buxhetit të shtetit.

Mehmeti ka thënë se mungesa e mbulimit të konsumit për pjesën veriore vazhdon të paraqesë problem për vendin.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, duke iu

referuar raportimit të KOSTT-it në Komisionin për Buxhet, tha se 113 milionë euro janë paguar për energjinë në veri për vitet 2021 dhe 2022. Sipas tij, këto mjete janë paguar nga buxheti i shtetit dhe nga dividenda e KOSTT-it për qeverinë. "Sivjet, deri në shtator, borxhi është rreth 25 milionë. Anomalia qëndron edhe në faktin se në vitin 2021 pagesa u bë me vendim të Kuvendit, ndërkaq në vitin 2022 u anashkalua Kuvendi dhe pagesa u krye me vendime të tjera", ka thënë Hoti.

Ai ka theksuar se qeveritarët e sotëm nuk kanë lënë gjë pa bërë kundër qeverive të kaluara kur ato detyroheshin t'i bënin pagesat

për energjinë në veri. "Tani paguajnë shumëfish më shumë dhe nuk i shihet fundi si do të mbyllet kjo çështje", ka deklaruar Hoti.

Kritika për pagesat rreth energjisë elektrike në veri të vendit pati edhe deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj. "Qeveria e Kosovës vazhdon t'i paguajë humbjet në veri dhe ajo që dua të theksoj është se edhe ish-qeveritë kanë paguar, por në një shumë më të vogël. Më kujtohet se në kohën e ish-qeverisë Haradinaj janë ndarë 1 milion euro dhe IV-ja sa ishte në opozitë nuk ka lënë gjë pa thënë", u shpreh Lekaj.



Arrihet marrëveshje me USAID-in për krijimin e sistemit elektronik për përcjelljen e faturave

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, së bashku me drejtoreshën e projektit "Integriteti i Komunave të Kosovës", Maia Gogoladze nënshkruan të mërkurën marrëveshjen e mirëkuptimit për krijimin e sistemit elektronik për përcjelljen e faturave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë tek organizatat buxhetore. Kjo marrëveshje e mirëkuptimit parasheh përmirësimin e shërbimeve publike duke krijuar një sistem elektronik përmes të cilit përcillen faturat në secilën hallkë të procedurës administrative përbrenda organizatave buxhetore, duke rritur kështu efikasitetin në shpenzimin e parasë publike dhe kontrollin e brendshëm financiar. Gjithashtu, krijimi i një sistemi të tillë elektronik



mundëson garantim të transparencës si pjesë e reformës për digitalizim dhe

zvogëlim të barrës administrative.

Në ceremoninë e nënshkrimit të

marrëveshjes, ministri Murati theksoi se "krijimi i sistemit elektronik do t'i zvogëlojë

mundësitë për keqpërdorime dhe do të mundësojë një menaxhim më të mirë të financave publike përmes rritjes së transparencës".

Në këtë linjë drejtoresha e projektit, Maia Gogoladze, ka theksuar se me këtë sistem do t'u mundësohet mbikëqyrësve institucionalë dhe operatorëve ekonomikë të shohin në kohë reale se në cilin hap të procesit gjenden faturat që të shmangen vonesat. "Dukshëm do t'i përmirësojë shërbimet ndaj operatorëve ekonomikë dhe do të mundësojë menaxhim më të mirë të financave publike në përgjithësi", ka thënë Gogoladze. Të dyja palët deklaruan edhe njëherë përkushtimin e tyre të përbashkët për zbatimin e projekteve të cilat përforcojnë mekanizmat e llogaridhënies dhe rritin efikasitetin në shpenzimin e parasë publike ashtu që të rritet shpejtësia e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Shënohet Java Botërore e Ndërmarrësisë në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bashkë me komunitetin e biznesit dhe partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim dhe zhvillim, ka shënuar Javën Botërore të Ndërmarrësisë, me mesazhin kryesor për krijimin e lidhjeve në mes të bizneseve fillestare dhe NVM-ve dhe zhvillimin e ekosistemit inovativ.

Ministrja Hajdari para të pranishmëve ka theksuar se Java Botërore e Ndërmarrësisë në Kosovë përcjell një urim dhe mbështetje për ndërmarrësit që kanë marrë guximin për të nisur një udhëtim, për të themeluar

biznese të suksesshme, në mënyrë që idetë e tyre të bëhen realitet, veçanërisht duke i përgëzuar ata individë që nuk e kishin menduar asnjëherë idenë e nisjes së një start-up-i, por që sot e lulëzojnë ekonominë tonë. "Janë ndërmarrësit e palodhur ata që marrin rreziqe, sfidojnë status quon dhe mendojnë jashtë kutisë për të gjetur zgjidhje për problemet e shoqërisë. Ata janë vizionarët që formojnë të ardhmen dhe frymëzojnë të tjerët t'i ndjekin gjurmët e tyre", ka pohuar ministrja Hajdari. Gjatë konferencës u paraqitën politikat dhe instrumentet, me

synimet e MINT-it për ta zhvilluar ndërmarrësinë në sektorë të ndryshëm industrialë dhe për t'i integruar ndërmarrësit tanë në zinxhirin global të vlerës.

Ndër temat e paraqitjes ishte Fondi për Inovacion, Ligji për Zejtarinë, instrumentet e politikës industriale për zhvillimin e inovacionit dhe digitalizimin e industrisë. Ndërmarrësit e ardhshëm dhe bizneset e vogla mund t'i rritin në masë të madhe shanset e tyre për zhvillim dhe rritje, duke krijuar lidhje më të ngushta me bizneset e suksesshme si yje në rritje në industrinë tonë.



Po rritet represioni ndaj shkrimtarëve



Nga: Stefan DEGE

Në mbarë botën, shkrimtarët, gazetarët dhe botuesit bien në shënjestrën e regjimeve të padrejta. Guximin për të shprehur mendimet ata e paguajnë me lirinë e vet. Kështu u burgos Iryna Danylovych nga gadishulli ukrainas i Krimësë, i pushtuar nga Rusia; Go Sherab Gyatso në Tibet që është pjesë e Republikës Popullore të Kinës; si dhe Soulaïman Raïssouni në Marok dhe María Cristina Garrido Rodríguez në Kubë.

Të katër autorët janë “të rrezikuar në mënyrë akute”, paralajmërojnë 140 qendrat e PEN-it në mbarë botën në një apel të përbashkët. Najem Wali, i ngarkuar për Writers-in-Prison [Shkrimtarët në burg] në Qendrën Gjermane PEN në Darmstadt, shton: “Përderisa njëri prej tyre nuk është i lirë, askush nuk është i lirë”.

Janë fate tragjike ato për të cilat PEN tërheq vëmendjen e publikut. “Shkrimtarët rezistojnë, angazhohen për drejtësi dhe shoqëri të lira”, thotë Wali për DW. “Për këtë arsye, shumë përndiqen, kërcënohen, sulmohen, burgosen, dëbohen dhe shpesh vriten.” Një

shembull i tillë është shkrimtari britaniko-amerikan me origjinë indiane, Salman Rushdie. Autori i “Vargjeve Satanike” mezi i mbijetoi një atentati në një skenë të hapur në gusht 2022. Së fundmi ai u nderua në Frankfurt mbi Main me Çmimin gjerman të Paqes.

Iryna Danylovych, gazetare ukrainase dhe aktiviste e të drejtave të njeriut, zbuloi abuzimet në sistemin shëndetësor në Krimenë e pushtuar. Më 29 prill 2022 ajo u rrëmbye me forcë. Në të njëjtën ditë forcat ruse të sigurisë bastisën shtëpinë e saj dhe i konfiskuan telefonin dhe pajisjet teknike. Vetëm pasi kaluan dy javë avokati i saj e gjeti atë në një qendër paraburgimi në Simferopol.

Ajo u akuzua për posedim të dyshuar eksploziv, u listua si “agente e huaj” dhe u dënua me shtatë vjet burg. Për të protestuar për kujdesin e dobët mjekësor në burg, Danylovych hyri në mars në grevë urie. Sipas familjarëve të saj ajo është në gjendje të rëndë shëndetësore.

As shkrimtari, pedagogu dhe intelektual i tibetian Go Sherab Gyatso, i njohur edhe si “Gosher”, nuk i është në gjendje më mirë. Shoqata e shkrimtarëve është e

shqetësuar edhe për shëndetin e tij për shkak të “mungesës së kujdesit mjekësor”. Gosher po vuan dënimin me 10 vjet burg. Sipas PEN-it, ai u dënua në fund të 2021 pas një gjyqi të fshehtë. Më parë forcat e sigurisë e patën arrestuar atë në qytetin Chengdu në provincën Sichuan me dyshimin për “nxitje të secesionizmit”.

Gosher iu dorëzua Rajonit Autonom të Tibetit dhe atje iu ngrit zyrtarisht akuza. Në shkrimet e tij i kushtohet budizmit tibetian, si dhe gjuhës dhe kulturës së Tibetit. Kishte kritikuar qeverinë e Kinës për kufizimin e aksesit të fëmijëve tibetianë në arsimin në gjuhën e tyre amtare.

Gazetari maroken Soulaïman Raïssouni nga ana tjetër u arrestua në maj 2020 për sulm të dyshuar seksual, të cilin ai e kundërshtoi si të motivuar politikisht. U mbajt për gati një vit në burg pa proces gjyqësor dhe më pas u dënua me pesë vjet burgim. Gjykimi u karakterizua me parregullsi dhe u zhvillua pa të dhe pa avokatët e tij mbrojtës, raporton PEN. Raïssouni gjithashtu është përgjuar. Pas një greve të gjatë urie, shëndeti i tij nuk është i mirë dhe ankesa e tij për të kaluar në gjyqin e apelit u refuzua. Kombet e Bashkuara dhe

Parlamenti Evropian shprehën shqetësimin për natyrën arbitrare të ndalimit të tij dhe kërkojnë lirinë e Raïssounit.

Të bazuara në pretekste ishin edhe akuzat kundër poetes dhe aktivistes kubane María Cristina Garrido Rodríguez. Ajo u dënua me shtatë vjet burg në mars 2022 për “çrregullim të rendit publik”, “sulm”, “nxitje për të kryer një vepër penale”, “rezistencë”. Më parë kishte marrë pjesë në protesta paqësore. Rodríguez po vuan dënimin në burgun e grave në Guatao. Atje trajtohet mizorisht, shpjegon PEN-i.

“Mekanizmat për persekutimin e autorëve të padëshiruar janë”, siç thotë Najem Wali, “të njëjta kudo në botë”. Diktaturat i tremben fjalës së lirë, sepse ajo nënkupton kujtesë dhe jo harresë. Kjo mund të çojë në protesta. “Diktatorët sundojnë me shpresën se njerëzit nuk kanë parë asgjë dhe nuk kanë dëgjuar asgjë – dhe për këtë arsye heshtin.” Shkrimtari Wali e përjetoi vetë këtë, kur u arrestua në Irak në vitet 1980 dhe përfundoi në qendrat e torturës të sundimitarit Saddam Hussein. Që nga maji 2022, Wali është i ngarkuar për Writers-in-Prison dhe zëvendës-president i Qendrës

Gjermane PEN.

Ndërkohë, Komiteti Ndërkombëtar i Writers-in-Prison me qendër në Londër jep një pamje të zymtë të gjendjes së lirisë së shprehjes. PEN International regjistroi të paktën 68 shkrimtarë dhe gazetarë të vrarë ose të kërcënuar në raportin e tij vjetor të vitit 2022, “kryesisht në Amerikën Veriore dhe Jugore, Evropë, Azi-Paqësore dhe Lindjen e Mesme”.

Sipas Walit, liria e shprehjes është aktualisht më e kërcënuar në Meksikë – e matur me numrin e gazetarëve dhe autorëve të vrarë. Por, gjëra të ngjashme mund të vërehen edhe në Kinë, Rusi, Turqi, Siri, Zimbabve dhe El Salvador. Është e vështirë, thotë Wali, të përpilosh një listë të renditjes. Megjithatë ka “pika të nxehta” si Irani me lëvizjen protestuese të udhëhequr nga gratë.

Që nga viti 1980 shoqata e shkrimtarëve PEN përkujton çdo 15 nëntor fatin e autorëve të përndjekur. Dita e përkujtimit u iniciua nga Komiteti Writers in Prison i PEN-it ndërkombëtar në përgjigje të asaj që ai e quan “numër në rritje të vendeve që përpigjen t’u mbyllin gojën autorëve përmes represionit”. /DW/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Hajdari rikthehet te Prizreni

PRIZREN, 15 NËNTOR - Basketbollisti i njohur Arti Hajdari është rikthyer në KB Proton Cable Prizreni. Hajdari, pas një edicioni të suksesshëm në KB Peja kaloi, në KB Sigal Prishtina për një periudhë të shkurtër. Tash është rikthyer në

klubin nga Prizreni. Arti Hajdari do të huazohet deri në dhjetor në skuadrën shqiptare Teuta nga Durrësi, më pas do t'i bashkohet Prizrenit. "Shumë dëshira, një zgjedhje! Arti Hajdari, pas një edicioni, është rikthyer sërish në skuadrën që

luajti për dy edicione. Arti është duke stërvitur me ekipin ndërsa kemi huazuar në kampionatin e Shqipërisë tek skuadra e Durrësit, Teuta të cilët edhe i falënderojmë për mundësin e transferimit dhe trajtimin e Artit. Nga fillimi i

muajit dhjetor, Arti do fillon zyrtarisht t'i mbroj ngjyrat bardh e zi. Ju rikujtojmë se Arti Hajdari ka qenë MVP i finales së Superkupës të fituar, kampion i stinorit të rregullt 2020-21", thuhet në njoftimin e KB Proton Cable Prizreni.



"Dardanët" nëpër shi vazhdojnë përgatitjet për ndeshjen ndaj Zvicrës

Kosova të shtunën e zhvillon ndeshjen kualifikuese ndaj Kombëtares së Zvicrës në Bazel. "Dardanët" të mërkurën nuk i kanë penguar as reshjet e dendura të shiut për t'u stërvitur për këtë ndeshje mjaft të rëndësishme. Stërvitja e radhës është në program sot, kurse të premten ekspedita e Kosovës udhëton drejt Zvicrës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINE, 15 NËNTOR - Reshjet e shiut nuk e kanë penguar Përfaqësuesen e Kosovës në futboll për t'i vazhduar përgatitjet për ndeshjen kualifikuese për "Euro 2024" ndaj Zvicrës. "Dardanët" janë stërvitur në Kampin Nacional në Hajvali, ndërsa edhe përkundër kushteve të vështira atmosferike, ata janë angazhuar maksimalisht për ta përmirësuar sa më shumë formën e tyre fizike. "Krahas punës në fushën e gjelbër, përzgjedhësi Primozh Gliha dhe stafi i tij po vazhdojnë

punën edhe në aspektin teorik. Ata po kryejnë videoanaliza të stërvitjeve të kaluara dhe lojës së fundit, si dhe po e analizojnë me kujdes kundërshtarin, duke përgatitur strategjitë e duhura për këtë ndeshje", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Kosova do të vazhdojë edhe sot (e enjte), ndërsa të premten "dardanët" do të udhëtojnë drejt Zvicrës. Mesfushori Qëndrim Zyba që luajti për mrekulli në ndeshjen ndaj Izraelit është shprehur i kënaqur me fitoren dhe paraqitjen e skuadrës përfaqësuese. "Është mirë që ne kemi fituar kundër Izraelit dhe



kjo është shumë e rëndësishme, por edhe ne si futbollistë të Superligës kemi bërë paraqitje të mirë. Shpresoj të qëndrojmë me këmbë në tokë, ta japim maksimumin në çdo ndeshje dhe të rritemi gradualisht", ka thënë Zyba, i cili më pas ka folur edhe për përballjen me

Zvicrën. Ai ka thënë se do të përpiqen maksimalisht të marrin rezultat pozitiv ndaj zvicranëve. "Patjetër se do të japim gjithçka nga vetja sepse çdo ndeshje e vlerësojmë maksimalisht. Padyshim se Zvicra është një kundërshtar shumë i fortë, por ne

mendojmë të japim maksimumin dhe, pse jo, të mos marrim rezultat pozitiv. Mendoj se kemi kualitet brenda grupit dhe kemi një atmosferë fantastike, prandaj pse të mos shpresojmë në rezultat pozitiv kur i kemi mundësitë për ta arritur një gjë të tillë", ka deklaruar Zyba.

Paraqitet programi shtetëror 'Sport në shkolla'



PRISHTINE, 15 NËNTOR - Ministria e Sportit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me federatat sportive, ka hartuar programin "Sport në shkolla", përmes të cilit po krijohet mundësia që të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar në Kosovë të jenë pjesëmarrës të rregullt në sport dhe aktivitete fizike. Pjesë e këtij programi është edhe Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) me basketbollin 3x3. Në paraqitjen e programit kanë marrë pjesë edhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe menaxherja e projekteve, Edita Medunjanin.

Në paraqitjen e së martës të programit morën pjesë ministri Hajrulla Çeku, së bashku me zëvendësministren Daulina Osmani, Avni Rexha, përfaqësues nga MASHTI, kërre të FSSHK-së, drejtorët e DKRS-ve të komunave të Kosovës, drejtorët dhe përfaqësuesit nga drejtoritë përkatëse komunale për sport dhe arsim, po ashtu përfaqësues të Departamentit të Sportit. Ministri Çeku theksoi vizionin e qeverisë për sportin dhe hapat konkretë të ndërmarrë për fuqizimin e mëtejshëm të sportit elitare, si trefishimi i mbështetjes financiare të sportit garues, krijimi

i standardeve të reja për zhvillimin e veprimtarisë sportive përmes reformës së kornizës ligjore si dhe prioritizimi i mbështetjes së organizimit të ngjarjeve sportive ndërkombëtare në Kosovë me qëllim të shndërrimit të sportit në sektor me ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit. Dren Marseli, menaxher i programit "Sport në shkolla", shpallosi komponentët që do të zbatohen në vitin shkollor 2023/2024, ku rreth 10 300 nxënës të 23 komunave do ta kenë mundësinë të jenë aktivë në aktivitetet sportive të përfshira në program.

Trajneri i Moldavisë: Kundër Shqipërisë do të japim gjithçka në fushë

Çisinau, 15 nëntor - Trajneri i Kombëtares së Moldavisë, Serghei Clescenco, lidhur me ndeshjen ndaj Kombëtares së Shqipërisë, e cila zhvillohet të premten, ka thënë se moldavët do të japin gjithçka në fushë

për të mos i zhgënjyer tifozët. "Ne realisht duam ta shohim stadiumin plot. Ende e mbaj mend ndeshjen e vitit 1998 kundër Gjermanisë. Tifozët qëndronin në këmbë pasi stolat ishin mbushur. Ata

brohoritnin pa pushim. Ne humbëm 1-3, por në 20 minutat e para kryesuaam 1-0. Lojtarëve u them që, pavarësisht rezultatit, ne nuk mund t'i zhgënjëjmë tifozët tanë në aspektin e lojës. Jemi

të motivuar për të dhënë gjithçka në fushë kundër Shqipërisë. Duam t'i bëjmë këto çaste historike të paharrueshme për të gjithë Moldavinë", ka thënë Clescenco.



Al Nassri mund të luajë në Ligën e Kampionëve

Riyadh, 15 nëntor - Al-Nassri i Cristiano Ronaldos mund të marrë pjesë në Ligën e Kampionëve në sezonin 2024-25. Kompeticioni më i rëndësishëm në Evropë ka pasur ekskluzivisht vetëm klube të lidhura me UEFA-n që konkurrojnë që nga fillimi i saj

tri dekada më parë. Megjithatë, tani është vendosur t'i ofrohet një ftesë skuadrës saudite të Pro League, Al-Nassr, për edicionin e vitit të ardhshëm, duke marrë parasysh popullaritetin e klubit në Evropë. Natyrisht një ftesë e tillë ndikohet edhe nga prania e

Cristiano Ronaldos, golashënuesit më të mirë të të gjitha kohëve në Ligën e Kampionëve me 140 gola, i cili iu bashkua klubit në dhjetor si lojtar i lirë. Një nga lojtarët më të mirë të planetit, 38-vjeçari Ronaldo, ngjan me verën, teksa ka nisur fuqishëm sezonin.

Kapiteni i Portugalisë ka shënuar 16 gola dhe ka dhuruar 9 asistime në 17 ndeshje në të gjitha garat. UEFA tani dëshiron ta shfrytëzojë popullaritetin e klubit të Arabisë Saudite dhe të Cristiano Ronaldos, duke planifikuar t'iu bëjë ftesë për sezonin 2024-2025.



Sylvinho për UEFA-n: Në Shqipëri e dashurojnë Kombëtaren

Tiranë, 15 nëntor - Shqipëria, mbi të gjitha trajneri Sylvinho, atë që po bën me kuqezinjtë, ka tërhequr edhe vëmendjen e UEFA-s. Faqja zyrtare e këtij institucioni i ka kushtuar një speciale të veçantë teknikut brazilian, mënyrën se si punon, si e sheh ai futbollin dhe çfarë ndryshon kur drejton një ekip kombëtar: "Lojtarët duhet ta shijojnë futbollin me kombëtaren e tyre. Kjo është mënyra si punohet për të nxjerrë diçka në dritë në vende të tjera të botës. Bëhet fjalë për zemrën e shpirtin e njerëzve në të gjithë vendin dhe kjo është shumë e veçantë si për lojtarët, ashtu edhe për trajnerin".

Në karrierën e tij fantastike Sylvinho ka pasur trajnerë të jashtëzakonshëm si Wenger dhe Pep Guardiola, por Sylvinho pëlqen ta ndërtojë imazhin e tij, të jetë Sylvinho, pasi futbollit ka ndryshuar shumë që nga koha kur ai luante futboll: "Janë të pabesueshëm të dy. Nuk pretendoj të jem Arsen Wenger apo Pep Guardiola. Unë dua të bëj punën time. Skuadra, stili... futbollit ka ndryshuar shumë, por unë besoj



në organizimin e grupit".

Sylvinho ka sjell diçka ndryshe te Shqipëria, mbi të gjitha rikthehu në pak kohë entuziazmin që i mungonte ekipit përfaqësues, fakt që e pranon edhe Elseid Hysaj: "E ndjek shumë, pasi është një trajner që na ka dhënë shumë dhe po na ndihmon gjithmonë. Është shumë energjik dhe na jep shumë pozitivitet si grup. Kishim shumë nevojë për këtë, pasi kemi pasur disa kohë kur nuk kishim shumë

atmosferë pozitive si skuadër dhe kishim nevojë për njerëz si Sylvinho. Tani është padyshim një nga trajnerët e mi më të pëlqyer". Në fund të këtij reportazhi fantastik, Sylvinho lëshoi edhe një herë apelin e tij për lojtarët: "Duhet të kesh shumë përgjegjësi, të luash me zemër dhe shpirt, sepse përfaqëson një shtet të tërë. Njerëzit që vijnë në stadium e dashurojnë ta shohin ekipin. Unë besoj gjithnjë te lojtarët".

Golden State në krizë, fitojnë lakersat, Miami dhe Denveri

LOS ANXHELOS, 15 NËNTOR - Humbja e katërt radhazi për Golden State, që ndodhet në krizë në NBA. Skuadra e Warriorsit u mund në fushën e saj me rezultat 104-101 nga Minnesota. Townsi me 33 pikë e 11 rebounde ishte më i miri për miqtë, ndërkohë që te Golden State u ndje mungesa e Curryt. Fitoi skuadra e lakersave, që



mundi me rezultat 134-107 Memphisin, duke korrur suksesin e tretë radhazi. Një lojë e mirë kolektive e lakersave, ku 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Denveri ruan kreun e renditjes në përfundim pas fitores me shifrat 111-108 ndaj clippersave. U dallua Jokiçi me 32 pikë e 16 rebounde. Në Lindje humbet ekipi kryesues i

Philadelphias, që u mund në shtëpi me rezultat 132-126 nga Indiana. Ndeshje me rivalitet, ku për miqtë u dallua Haliburton me 33 pikë e 15 asistime. Fitoi edhe skuadra e Miamit, që falë 32 pikëve të Butlerit, mundi me rezultat 111-105 Charlotten, ndërsa Atlanta mposhti 126-120 Detroitin (Murray 32 pikë).

REZULTATET

Charlotte - Miami	105-111
Detroit - Atlanta	120-126
Philadelphia - Indiana	126-132
Brooklyn - Orlando	124-104
Oklahoma - San Antonio	123-87
New Orleans - Dallas	131-110
Utah Jazz - Portland	115-99
Denver - Clippers	111-108
Golden State - Minnesota	101-104
Lakers - Memphis	134-107

Songu pensionohet nga futbollit

Ish-mesfushori i Barcelonës dhe Arsenalit, Alex Song, ka njoftuar përfundimisht se është pensionuar nga futbollit. Gjatë karrierës së tij Song ka luajtur me ekipe si Bastia, në

Francë, West Ham e Charlton në Angli, Rubin Kazan, në Rusi, Sion, në Zvicër, ndërsa "aventurës" së tij në fushën e blertë i dha fund, në Xhibuti, ku aktivizohej me skuadrën AS

Arta/Solar7. "Me pikëllim të madh ju njoftoj se ka ardhur momenti t'i var këpucët në gozhdë. Udhëtimi im që filloi në Yaounde si fëmijë, duke luajtur pa këpucë futbollit, me

këmbë të zbathura dhe në zhvorr të fortë, më dha forcë dhe guxim për të pasur sukses. Kur u transferova në Francë, duke luajtur për Bastian, mendova se kisha arritur një

mrekulli. Megjithatë, ky ishte vetëm fillimi, pasi rrugëtimi im vazhdoi drejt Arsenalit e Barcelonës, dy nga klubet më të mëdha në botë", ka shkruar 36-vjeçari Song.

SHKURT

Reali planifikon t'ia rrëmbejë Leverkusenit trajnerin dhe tre futbollistë

Real Madridi po planifikon angazhimin e trajnerit Xabi Alonso nga Bayer Leverkuseni. Alonso po shihet si një zëvendësues ideal për Carlo Ancelottin. Kjo nuk është e tëra, pasi Reali po planifikon t'ia rrëmbejë Leverkusenin edhe tre futbollistë, raporton "Football Transfer". Bëhet fjalë për Florian Wirtz (20-vjeçar), Jeremie Frimpong (24-vjeçar) dhe Victor Boniface (22-vjeçar). Wirtz ka një kontratë deri në vitin 2027 me Leverkusenin dhe kushton 80 milionë euro. Frimpong ka një kontratë deri në vitin 2028 dhe kushton 44 milionë euro, ndërsa Boniface kushton 40 milionë dhe ka kontratë deri në vitin 2028 me gjermanët.

Zbulohet topi zyrtar i 'Euro 2024'

Topi zyrtar që do të përdoret në ndeshjet e Kampionatit Evropian të futbollit "Euro 2024" është zbuluar nga UEFA dhe "Adidas" në një ngjarje speciale në Berlin. Topi i emëruar "Fussballliebe" përmban teknologjinë "adidas Connected Ball Technology" për herë të parë në një Kampionat Evropian duke ofruar një pasqyrë të paparë në çdo element të lëvizjes së topit dhe duke kontribuar në procesin e vendimmarrjes së video-asistentëve të UEFA-s.

Fury dhe Usyk arrijnë marrëveshje për duelin historik

Tyson Fury dhe Oleksandr Usyk, dy boksierët më të mirë aktualisht në botë, kanë planifikuar të "luftojnë" më 17 shkurt të vitit të ardhshëm. Sipas "ESPN", ndeshja duhet të zhvillohet në Arabinë Saudite dhe fituesi duhet t'i unifikojë të gjitha rripat në kategorinë e peshave të rënda, pra të bëhet pesha e rëndë e padiskutueshme më e mirë në botë. Tyson Fury mban rripin WBC, i vetmi që i mungon ukrainasit Usyk. Me fitoren ndaj Anthony Joshuas, ukrainasi mori katër pjesët e mbetura - WBA, IBO, WBO dhe IBF. Ndeshja e fundit e Furyt ishte kundër luftëtarit të MMA, Francis Ngannou, në të cilën ai fitoi me pikë, ndërsa Usyk hodhi në nokaut britanikun Daniel Dubois. Ka kohë që spekulohet për këtë duel. Madje Fury dhe Usyk duhej të ndesheshin në dhjetor të këtij viti, por ndeshja e Furyt me Ngannou i zhvendosi planet. Njoftimi zyrtar i datës së këtij meçi pritet të bëhet të enjten.

Union Berlini pas pesë vjetësh e shkarkon trajnerin

Union Berlini ishte një nga surprizat më të bukura sezonin e kaluar në Evropë, duke arritur të kualifikohej për në Ligën e Kampionëve për herë të parë në historinë e klubit. Duket se kjo arritje nuk i bëri mirë skuadrës gjermane, që tashmë ndodhet në vendin e fundit në Bundesligë me vetëm 6 pikë të grumbulluara. Për këtë arsye, Union Berlini ka marrë vendimin drastik për trajnerin zviceran Urs Fischer, duke e shkarkuar nga detyra pas pesë vjetësh. Ai arriti të ngjiste për herë të parë në elitë skuadrën dhe bëri të mundur çdo arritje tjetër, nga kualifikimi në kompeticionet evropiane, deri te Liga e Kampionëve. Gjithsesi rezultatet e fundit nuk kanë qenë në favor të tij, me klubin që e pa si mundësi të vetme shkarkimin e Fisherit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1259/1
Dt: 15.11.2023

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Ligjit nr.08/L- 197 për Zyrtarët Publik, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkoll a	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësi m	Numri i pozitive
SHML	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi"	Malishevë	Mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane (20 orë mësimore)	Vend i lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane në shkollë të mesme të lartë:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2023/2024 (Shtator 2023 – Gusht 2024);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitë e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail (konkurset) dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në tabelën e shpalljeve në Shkollë dhe do tu dërgohen kandidatëve me e-mail.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: 16.11.2023 deri më datën 30.11.2023.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollë, Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të publikohen në tabelë të shpalljeve në Shkollë.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

Emri i biznesit B5 Inframain SH.P.K. si dhe me emër tregtar B5 Infrastructur&Maintenance me Numër Unik Identifikues: 811574583, ka marr vendim për zvogëlim të kapitalit nga 2000.000 në 20.000 Euro.

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

- Driton Avdiu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Kimete Ramadani" shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme vitit 1998/2001 "Xheladin Deda".

- Agnesa Hamzaj shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e vitit III dhe IV të shkollës së mesme "Xheladin Deda".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimin e Bordit të datës 02.10.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 16.11.2023 të Rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Zyrtar/e Ligjor/e - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi
Numri i referencës: 10-02-59

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e procedurave përkatëse, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
- Kryen detyrat e parapara me plan të punës të miratuar në përputhje me ligjin, rregulloret, politikën dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bënë hulumtime ligjore, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandon për shqyrtim dokumentacionin me mbikëqyrësin,
- Merr pjesë në seanca gjyqësore kur kjo i kërkohet;
- Kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare lidhur me lëndët dhe informatat të cilat i bëhen të ditura gjatë punës;
- Koordinon punën me pjesët tjera të Kompanisë dhe komunikon, sipas nevojës edhe me autoritetet e jashtme, gjithnjë duke u kujdesur për paraqitje të denjë të Kompanisë;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.
- Kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi drejtëpërdrejtë;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të ketë diplomën universitare të Fakultetit Juridik
- Të ketë njohuri të shkëlqyera në interpretimin e ligjeve dhe akteve nënligjore
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe aftësi për të punuar nën presion;
- Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe punës ekipore;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe të kryejë detyrat me mbikëqyrje minimale;
- Preferohet njohja e gjuhës serbe dhe angleze

Procedura e Aplikimit:

- Aplikacioni
- CV - ja
- Kopja e Letërnjoftimit
- Letër motivuese;
- Diplomat, Certifikatat dhe dokumentet tjera relevante;
- Deklarata nën betim

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 16.11.2023 deri më datën 30.11.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimin e Bordit të datës 02.10.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 16.11.2023 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Zyrtar/e Administrativ/e - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi
Numri i referencës: 10-02-60

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët e Zyrarit të cilat i përcaktonë Kryeshefi Ekzekutiv ;
- Pranon palët dhe i prezanton te K.E për pranim;
- Mban evidencën zyrtare të thirrjeve telefonike dhe takimeve;
- Pranon thirrjet dhe shkresat, kryen punët kompjuterike nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe punë tjera teknike që i cakton Kryeshefi Ekzekutiv , siq janë:
- Shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve, mbajtja e protokollit dhe arkivimi i dokumenteve dhe të postës për dorëzim intern dhe ekstern, i të njejtave;
- Kryen edhe detyra tjera të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga K.E;
- Si dhe punë tjera të kësaj natyre.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të ketë shkollën e mesme ;
- Të prezantoj letërnjoftimin;
- Shkathtësi në komunikim;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel); ose administrative.
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës)

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 16.11.2023 deri më datën 30.11.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Tricontes Prishtina" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810148735 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa "Tricontes Prishtina" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810148735 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Tricontes Prishtina" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810148735 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.


Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

